




Komuna e Gjakovës



Marrëveshje Bashkëpunimi dhe Bashkëfinancimi

në mes të

Komunës së Gjakovës

dhe

Caritas Kosova

Me qëllim të vendosjes së bashkëpunimit në mes të Komunës së Gjakovës dhe Caritasit të Kosovës, palët nënshkruese pajtohen të lidhin këtë marrëveshje bashkëpunimi dhe bashkëfinancimi për Funksionimin e Qendrës Sociale-Edukative 'Caritas Kosova' në lagjen Ali Ibra në Gjakovë. Kjo marrëveshje vjen pas bashkëpunimit shumëvjeçar në misionin e përbashkët të Palëve në përfshirjen sociale të komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian.

Neni 1 - Palët

Palët e kësaj Marrëveshje janë:

- **Komuna e Gjakovës** - prezantuar nga, *z. Ardian Gjini - Kryetar i Komunës*, dhe
- **Caritas Kosova** - prezantuar nga *Don Viktor Sopi - Drejtor Gjeneral*

Neni 2 - Qëllimi

Kjo marrëveshje lidhet me qëllim të financimit të projektit të përbashkët me titull:

"Funksionimi i Qendrës Sociale-Edukative "Caritas Kosova" në Ali Ibra, Gjakovë"

Neni 3 - Fushëveprimi

Kjo marrëveshje parasheh funksionimin e Qendrës dhe aktivitetet kryesore ndërlidhen me:

- **Edukimin e fëmijëve parashkollor nga mosha 3-6 vjeç**
- **Programin 'ndihmë në detyrat e shtëpisë'**
- **Përkujdesi për shëndetin dhe mirëqenien e fëmijës**
- **Ofrimin e shërbimeve shëndetësore në kuadër të projektit të Caritas Kosova të quajtur Home Care**
- **Asistencë sociale për familjet në nevojë të komuniteteve Rom, Ashkanli dhe Egjiptian**
- **Aktivitete psiko-sociale, kulturore dhe sportive**
- **Çështje të tjera të karakterit social dhe humanitar**

Neni 4 - Kohëzgjatja

Periudha kohore e implementimit të marrëveshjes: 1 Tetor 2018 – 31 Dhjetor 2019

Neni 5 - Obligimet e palëve

Me qëllim të zbatimit të marrëveshjes Caritas Kosova merr përgjegjësi këto obligime:

1.1 Caritas Kosova është pala përgjegjëse për zbatimin e projektit ku do të menaxhoj dhe përcjellë nga afër tërë veprimtarinë e stafit profesional të punësuar në këtë projekt, në mënyrë që të veprojnë në bazë të planit të veprimit dhe orareve të vendosura nga Palët.

1.2 Caritas Kosova, do të bashkëpunojë me institucionet relevante të Komunës së Gjakovës, respektivisht me Drejtorinë e Arsimit, me Drejtorinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, me Zyrën për Kthim dhe Komunitete, etj. Caritas Kosova do të përgatis raporte në baza vjetore për të prezantuar zhvillimin e projektit, rezultatet e arritura si dhe raportet financiare. Po ashtu Caritas Kosova do të kompletoj lëndët, përpiloj faturat dhe dorëzoj në drejtoritë përkatëse sipas udhëzimeve të personit zyrtar të Komunës. Të njëjtat do të ju dërgohen institucioneve bashkëpunuese të sipër përmendura.

1.3 Caritas Kosova do të ofroj trajnime për stafin profesional në mënyrë që puna të jetë profesionale dhe konform ligjeve dhe normave të aplikueshme në nivel të vendit.

Me qëllim të zbatimit të marrëveshjes Komuna e Gjakovës merr përgjegjësi këto obligime:

2.1 Të monitoroj zbatimin e projektit.

2.2 Të kryej obligimet financiare sipas Nenit 6 të kësaj marrëveshje.

Neni 6 - Financimi

Komuna e Gjakovës dhe Caritas Kosova do të bashkë financojnë realizimin e këtij projekti me kosto të përgjithshme prej **47,175.00 €**.

Komuna e Gjakovës do të participoj me shumën **20,515.00 €**

Caritas Kosova do të participoj me shumën prej **26,660.00 €**

Vlera e participimit nga Komuna e Gjakovës do të transferohet në llogarinë bankare të Caritas Kosova në dy këste:

1. kësti i parë, në vlerë prej **5,140.00 €** pas nënshkrimit të marrëveshjes, në muajin tetor 2018.
2. kësti i dytë, në vlerë prej **5,125.00 €** deri në fund të muajit mars 2019.
3. kësti i tretë, në vlerë prej **5,125.00 €** deri në fund të muajit qershor 2019.
4. kësti i katërt, në vlerë prej **5,125.00 €** deri në fund të muajit tetor 2019.

Të dhënat e llogarisë bankare:

PROCREDIT BANK

KOS CATHOLIC CHURCH CARITAS NGO

Nr: 1170 0170 0100 0163

Neni 7 - Anekset

Pjesë e bashkëngjitur e kësaj Marrëveshje është plani buxhetor i këtij projekti.

Neni 8 - Zgjidhja e mosmarrëveshjes

Palët nënshkruese të kësaj Marrëveshje pajtohen që me mirëkuptim, konsultim dhe negociim të zgjidhin të gjitha çështjet kontestuese që mund të lindin gjatë zbatimit të Marrëveshjes. Në të kundërtën kompetente është Gjykata Themelore në Gjakovë.

Neni 9 - Hyrja në fuqi

Kjo marrëveshje bashkëpunimi dhe bashkëfinancimi hyn në fuqi në datën e nënshkrimit dhe është e përpiluar në 4 ekzemplar të njejt, nga dy për secilën palë.

Data e nënshkrimit: 27-09-2018

Palët nënshkruese

Ardian Gjini
Kryetar
Komuna Gjakovë



Don Viktor Sopi
Drejtor Gjeneral
Caritas Kosova

A handwritten signature of Don Viktor Sopi over a horizontal line.